



Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 10 të Ligjit Nr.03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37 paragrafi 2 nën paragrafi (c) të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 3, nenin 5, paragrafi 5.1.3, nenin 6 dhe nenin 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal Nr.01/2017, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 10.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Emërimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal

- I. **Z.Ramadan Parduzi**, emërohet anëtar i kuvendit komunal në Vushtrri, nga subjekti politik "Lidhja Demokratike e Kosovës", duke e zëvendësuar anëtarin e kuvendit komunal z.Alban Bajrami.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet z.Ramadan Parduzi dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 09.01.2025, Nr.07/7-35/2025, për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal z.Alban Bajrami, i cili ka dhënë dorëheqje për arsye se, është angazhuar në pozitë tjetër. Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidati i radhës në listën e rirenditur është z.Ramadan Parduzi. Kandidati i radhës ka dhënë deklaratën e pranimit të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021.

Andaj, pas plotësimit të kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 10.01.2025





Komisioni Qendror i Zgjedhjeve • Centralna Izborna Komisija • Central Election Commission
Republika e Kosovës • Republika Kosova • Republic of Kosova

KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin 63, nenin 78, nenin 113.4 të Ligjit Nr.08/L-228, për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, si dhe nenin 11 paragrafi 1 të Rregullores Zgjedhore Nr.11/2024 Këshillat e Vendvotimeve, si dhe vendimin e Nr.01/973-2024 të datës 21.06.2024 për miratimin e Planit të buxhetit, në mbledhjen e rregullt të mbajtur më datë 10.01.2025, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Mëditjeve për Pagesat e Stafit të Angazhuar në Qendrat e Votimit (QV), në Vendvotime (VV), Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) dhe në Përfaqësitë Diplomatike

- I. Miratohen mëditjet për pagesat e stafin të angazhuar në Qendrat e Votimit (QV), në Vendvotime (VV), Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) dhe në Përfaqësitë Diplomatike, për zgjedhjet e rregullta për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më 09 shkurt 2025, si në vijim:
 1. Pesëdhjetë EURO (50) € në ditë çdo Menaxheri të Qendrës së Votimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht. Menaxherët e Qendrave të Votimit, do të paguhën për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
 2. Gjashtëdhjetë EURO (60) € në ditë, çdo Kryesuesi të Këshillit të Vendvotimit në vendvotimet e rregullta dhe me kusht. Kryesuesit e Këshillit të Vendvotimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
 3. Pesëdhjetë EURO (50) € në ditë, çdo Anëtar i të Këshilli të Vendvotimit, në vendvotimet e rregullta dhe me kusht. Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
 4. Njëqindnjëzet EURO (120) € në ditë çdo Menaxheri të Qendrës së Votimit në Përfaqësitë Diplomatike. Menaxherët e Qendrave të Votimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
 5. Njëqind EURO (100) € në ditë, çdo Kryesuesi të Këshillit të Vendvotimit në vendvotimet në Përfaqësitë Diplomatike. Kryesuesit e Këshillit të Vendvotimit, do të paguhën për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;

6. Nëntëdhjetë EURO (90) € në ditë, çdo Anëtari të Këshilli të Vendvotimit, në vendvotimet ne përfaqësitë diplomatike. Anëtarët e Këshillave të Vendvotimit, do të paguhet për periudhën kohore prej tri (3) ditësh;
 7. Gjashtëdhjetë EURO (60) € në ditë, çdo Zyrtari të Tavolinës Ndhimëse në Qendër të Votimit. Zyrtarët e Tavolinës Ndhimëse, do të paguhet për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
 8. Pesëdhjetë EURO (50) € në ditë, çdo Anëtari Rezervë të Këshillit të Vendvotimit në Qendër të Votimit. Anëtarët Rezervë të KVV-ve, do të paguhet për periudhën kohore prej një (1) ditësh;
 9. Tridhjetë EURO (30) € në ditë, çdo Shërbim të transportit për transportimin e materialit jo të ndjeshëm dhe të ndjeshëm zgjedhor, do të paguhet për periudhën kohore prej dy (2) ditësh;
 10. Pesëdhjetë EURO (50) € në ditë, do të paguhet, çdo Kryesues te Ekipit të numërimit në QKN.
 11. Katërdhjetë EURO (40) € në ditë, do të paguhet, çdo Anëtar te Ekipit të numërimit në QKN.
- II. Pagesat për të gjitha kategoritë e sipër përmendura janë llogaritur në Neto.
- III. Obligohen Zyrtarët e Ekzekutiv të KKZ-ve dhe anëtarët e KKZ, që brenda pesë (5) ditëve, pas ditës së zgjedhjeve (09.02.2025) t'i dorëzojnë listat e pagesave me saktësi në formë fizike (të nënshkruar) dhe elektronike, në SKQZ.
- IV. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, për zbatimin e këtij vendimi.
- V. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 10.01.2025

